



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Njesia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/10 Nr. ifaq/Br.str/No.pg 74

Data/Datum/Date 31.01.2025



**INFORMATË RRETH AKTIVITETEVE TË KKSBSË PËR VITIN
2024**



JANAR – 2025

HYRJE

Të nderuar kuvendarë/e të Kuvendit Komunal të Rahovecit,

Bazuar në ligjin Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave të neneve 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush informatën lidhur me aktivitetet, punët, angazhimet dhe arritjet e Këshillit Komunal për Siguri Në Bashkësi përgjatë periudhës janar- dhjetor 2024.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është themeluar me vendim të Kuvendit Komunal me datë 25.01.2022, ku anëtarët e këtij këshilli janë përzgjedhur sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL, ku është bërë shpallje publike, në këtë shpallje janë përcaktuar kriteret të cilat duhet t'i plotësoj një kandidat për të qenë pjesë e këtij këshilli.

QËLLIMI I INFORMATËS

Përmes kësaj informate jemi munduar të krijojmë një pasqyrim të qartë për kuvendarët/et dhe qytetarët, lidhur me aktivitetet e dhe punët që janë kryer në Këshillin Komunal Për Siguri në Bashkësi. Kjo informatë ka për qëllim që të rrit transparencën dhe llogaridhëni e Kuvendit të Komunës së Rahovecit karshi qytetarëve.

FUNKSIONIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI NË KOMUNËS E RAHOVECIT

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi funksionon në bazë të legjislacionit i cili është në fuqi në Republikën e Kosovës, ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave të neneve 3 dhe 4, udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL dhe vendimit të Kuvendit Komunal me datë 25.01.2022

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi udhëhiqet nga Kryetari i Komunës z. Smajl Latifi dhe Koordinatori i KKSBB-së z. Skender Hamza.

ANËTARËT E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI JANË:

- 1.1 Smajl Latifi** - Kryetari i Komunës, kryesues;
- 1.2 Fazli Morina** - Komandanti i stacionit të Policisë;
- 1.3 Nysret Abazibra** - Bashkësia Islame – Rahovec;
- 1.4 Ylvi Shehu** - Teqja e Madhe "Shejh Sylejmanit";
- 1.5 Sabahudin Durgutti** - Teqja e "Haxhi Shej Illiaz Shehu";
- 1.6 Milan Stanojevic** - Kisha Ortodokse serbe;
- 1.7 Biljana Nakalamic** – Komuniteti serb;
- 1.8 Egzon Hamza** - Komuniteti Egjiptian;
- 1.9 Valon Berisha** - Komuniteti Romë;
- 1.10 Bujar Morina** - Komuniteti Ashkali;
- 1.11 Bajram Morina**, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete;
- 1.12 Abestrim Rexhepi** - përfaqësues i FSK-së;
- 1.13 Alban Gashi** - Zyrtar/e për barazi gjinore;
- 1.14 Avni Morina** - Drejtëor i Drejtorisë për Arsim;
- 1.15 Erseka Cana** - Kryetar i Këshillit të Prindërve;
- 1.16 Enis Berisha** - KLSP;
- 1.17 Beqir Hamza** - KEVSB;
- 1.18 Shani Hoti** – Ratkoc, KLSP- Sektori C.
- 1.19 Besmire Bytyqi** - Drejtëor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim;
- 1.20 Vjollca Gurguli** - SHL-Kosova;
- 1.21 Lendrit Qelaj** - ZKKK;
- 1.22 Shaip Shala** - Media lokale;
- 1.23 Mustaf Korenica** - Komuniteti i bizneseve;
- 1.24 Lulzim Krasniqi**- Përfaqësues i Komunitetit të personave me aftës të kufizuar.

DETYRAT DHE PËRGJEGJESIT E KKSB-SË

Përgatitja e planit vjetor të punës dhe zhvillimi i projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi, identifikimi i dukurive negative, që mund të prishin sigurinë publike dhe rekomandojnë planet e veprimit, bashkëpunojnë me policinë për parandalimin e veprimeve të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi. bashkëpunojnë me institucionet qendrore, që merren me sigurinë publike, me qellim të krijimit të një ambienti më të sigurt në bashkësi. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSB-të, të komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi, që i tejkalojnë kufijtë e komunës së tyre. Sigurimi i financimit të projekteve nga Kuvendi i Komunës që kanë të bëjnë me sigurinë në bashkësi. Përmes komunës, kërkon nga ndonjë organizatë jo-qeveritare, financimin e projekteve që lidhen me sigurinë në bashkësi, fton në takimet e tyre përfaqësuesit nga MPB dhe institucione tjera gjegjëse, kërkon nga policia përgjigje për rastet që janë me rëndësi për sigurinë në bashkësi, duke mos ndërhyrë në procesin e hetimeve policore. Mbajtja e takimeve të rregullta, bëhet sipas nenit 11, të Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012MPB-03/2012 MAPL.

Kuvendi i Komunës, ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të këtij vendimi të anëtarëve të KKSB-së.

Anëtarët e KKSB-së kanë mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit Komunal.

AKTIVITETET E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2022

Në vitin 2024 kryetari i komunës i ka mbajtur gjithsej 7 mbledhje të rregullta dhe 1 mbledhje urgjente të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, ku të gjitha këto mbledhja janë mbajtur sipas planit të aprovuar në 27.12.2023, pra janë respektuar të gjitha pikat e rendit të ditës të planit, gjithashtu ka pasur edhe pika shtesë, kjo është varur nga gjendja dhe situata e cila ka qenë në kohën kur është mbajtur takimi.

Përpos diskutimeve dhe debateve që janë bërë në këto takime sa i përket pikave të rendit të ditës, gjithmonë në fund të takimeve janë marr rekomandimet dhe konkluzat.

Më poshtë do iu paraqesim të gjitha takimet nga mbledhjet e Këshillit për Siguri në Bashkësi: Si dhe pikat e rendit të ditës, poashtu edhe konkluzat që kanë dalë nga këto takime.

Mbledhjet e mbajtura për vitin 2024 nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi janë:

Pikat e rendit të ditës nga Mbledhja e KKSB-së e mbajtur me 31.01.2024

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak 2023;**
- 3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;**
 - Siguria në trafik;
 - Ushtimi i kontrollit më të shpeshtë të trafikut rrugor për të zvogëluar aksidentet me fatalitet;
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit;
- 4. Trajtimi i qenve endacakë;**
- 5. Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje;**
- 6. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme;**
- 7. Organizimi i trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit e shkollave;**
- 8. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat;**
- 9. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;**
- 10. Të ndryshme.**

Për të gjitha pikat ka pasur diskutime, por si pikë më me rëndësi dhe që ka pasur më shumë interesim ka qenë pika Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, në

këtë pikë gjithmonë ka raport të detajuar nga Komandanti i Policisë së Stacionit në Rahovec, ku njoftohen anëtarët e KKSBS-së rreth situatës së sigurisë në Komunën e Rahovecit.

Konkluzioni nga takimi i KKSBS-së i datës 31.01.2024

Konkluzioni rreth pikës së tretë: *Kryetari – Pas prezantimit të raportit të komandantit të stacionit policor mundemi të konsiderojmë që në komunën tonë ka pasur stabilitet dhe siguria e përgjithshme ka qenë e qetë.*

Konkluzioni rreth pikës së katërt: *Komuna janë, për tri vjet ka ndarë mbi 100.000€ për trajtimin e qenve endacakë dhe shpresojmë që do të kemi shembuj të tjerë të komunave që na rrrethojnë. Deri më tanë janë të trajtuar 321 qenë endacakë dhe sipas kësaj kontrate duhet të trajtohen edhe 679 të tjerë. Operatori vepron në përputhje me shqetësimet që i paraqesim. Kontrata ka kufizime për shkak të ligjit për mbrojtjen dhe trajtimin e kafshëve.*

Konkluzioni rreth pikës së pestë: *Jam për organizimin e një tryeze ku janë inspektorët, prokurorët, gjyqtarët, policia, OSBE-ja. Të bëhet raportimi te organet kompetente nëse ka rritje të dhunës dhe të diskutohet plani i veprimit për parandalimin e dhunës në përgjithësi dhe dhunës në familje në veçanti.*

Konkluzioni rreth pikës së gjashtë: *Në gjysmën e parë të muajit shkurt, do të kujdesemi që ta organizojmë një takim me drejtore të shkollave, kryetarë të këshillave drejtues të shkollave dhe me koordinatorë të cilësisë, të pranishëm do të jenë edhe policia dhe psikologët. Tema do të jetë: Trajtimi i çështjes së sigurisë në shkolla dhe masat parandaluese.*

Konkluzioni rreth pikës së shtatë: *Kjo pikë për herë të parë është këtë vit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Rahovecit, jemi në fazën fillostarte në përgatitjen e disa trajnimeve me nxënës kryesish të shkollave të mesme. Pretendojmë që këto trajnime t'i mbajmë në muajin maj dhe prill.*

Konkluzioni rreth pikës së tetë: *Vazhdojmë t'i kemi disa kontrata aktive për t'i trajtuar shtretërit dhe do të kujdesemi që në lumenjtë e komunës tonë mos të kemi ujëra të zeza. Për ta dëshmuar këtë që po e them është edhe shembulli që jemi duke i eliminuar ujërat e zeza dhe që po futet kolektori i madh i ujërave të zeza nga Fortesa, deri në Rahovec. Kërkoj që inspektorati i mjedisit të kujdeset rreth asaj që nuk është mirë të ketë ujëra të zeza.*

Konkluzioni rreth pikës së nëntë: *Te kontrolli i produkteve ushqimore: kemi gjetur mallra të skaduara dhe barna. I kemi dënuar ose kemi kërkuar prej inspektoratit sanitar për reagim. Kompetencat e inspektoratit pothuajse të gjitha janë centralizuar. Me një inspektor të mjedisit që e kemi ne, dhe me dy të tjerë që i ka shteti i Kosovës, për besë është problem. Si kryetar i Komunës dhe si kryesues i KKSBS-së, ju ftoj për koordinim dhe bashkëveprim në këtë çështje*



Pikat e rendit të ditës nga mbledhja urgjente e KKSBB-së e mbajtur me 28.02.2024

Rend Dite

1. Shqyrtimi i gjendjes aktuale të sigurisë në Komunën e Rahovecit;
2. Të ndryshme.

Konkluzion nga takimi i KKSBB-së i datës 28.02.2024

Konkluzioni rreth pikës së Parë: Kryetari: Mbledhja urgjente, që si qëllim kryesor ka qenë përmirësimi i gjendjes së sigurisë në komunën tonë. Fakti që kanë ndodhur disa veprime, të cilat te ne e kanë krijuar një gjendje jo të lehtë emocionale për familjet e prekura. Dëshiroj ta theksoj faktin që ne kemi organe ligjore me detyra dhe përgjegjësi në fushëveprimtari të caktuara dhe të gjitha këto na jepin të drejtën të themi që siguria në komunën tonë, pavarësisht veprimeve të dëmshme të keqbërësve, është e qetë dhe stabile.



Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSBB-së e mbajtur me 15.03.2024

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;**
 - Siguria në trafik;
 - Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Vetëdijesimi i nxënëseve për rrezikun nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyera nga lufta;
 - Trotuaret dhe shenjat sinjalizuese në territorin e Komunës;
 - Identifikimi dhe lirimi i hapësirave publike, konkretisht trotuareve.
- 3. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme;**
- 4. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndëretnik, multikulturor dhe ndërfetar.**
- 5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat.**

6. Siguria dhe kontrolli Konkluzion nga takimi i KKSBB-së i datës 15.03.2024

Konkluzioni rreth pikës së dytë: Mund të konstatojmë që situata e sigurisë ndërmjet dy takimeve, ka vazhduar të jetë e qetë dhe stabile, pavarësisht veprimeve të dëmshme të keqbërësve, situata vazhdon të jetë e qetë dhe stabile.

Konkluzioni rreth pikës së tretë: Gjatë kësaj periudhe kemi vazhduar me koordinimin DKA - stacion policor, rreth ligjëratave vetëdijesuese që po mbahen nëpër shkolla. Temat e trajtuar janë në përputhje me planin operativ që e kanë hartuar zyrtarët policorë.

Sa i përket ndriçimit, nuk e besoj që është ndonjë komunë e Kosovës me ndriçim më shumë se sa komuna e Rahovecit. Investimi në ndriçim publik është si element thelbësor i sigurisë së përgjithshme do të vazhdojë në zgjerim dhe në mbikëqyrje.

Konkluzioni rreth pikës së katërt: Ne kemi një zyrë komunale për komunitete e kemi Komitetin për Komunitete, që është organ obligativ i Kuvendit të Komunës, si dhe plot veprime që jemi duke i zhvilluar, të cilat në instancë të fundit kanë për qëllim të krijojnë pasqyrë që qytetarët trajtohen njësoj, pa dallim se ku jeton dhe çfarë përkatësie etnike ka. Gjithashtu, edhe në aspektin e investimeve ka trajtim të barabartë. Fusha e sportit që e përruam dje në Shkollën "Gëzim Hamza" është vepër e ZKKK-së. Punojmë me këtë koncept, duke planifikuar shumë aktivitete të tjera kulturore me mbështetje nga OSBE-ja, KFOR-i dhe e mira e kësaj është që nuk kemi probleme fetare, ndërkulturore apo ndëretnike.

Konkluzioni rreth pikës së pestë: E shfrytëzoj rastin që t'ju them që ai që hedh mbeturina do të dënohet deri në 2000€ gjobë. Ju ftoj që të gjithë ju dhe ne së bashku t'i raportojmë rastet në inspektorat. Nëse e kemi qytetin e pastër, komuna fiton grante nga Evropa, Amerika, USAID-i dhe qeveria.

Konkluzioni rreth pikës së pestë: Një pjesë e inspektorëve i ka centralizuar qeveria. Inspektorin sanitari, inspektorin e punës, inspektorin e tregut, sektorin e pyjeve, te këta asnjë fije kompetence nuk e kemi si komunë. Te kontrolli i produkteve ushqimore, konsumatori mund t'i telefonojë disa numra për kontolle ushqimore, për të qenë sa më të sigurt në ushqimet tona. Përndryshe, inspektorati ynë shqipton gjoba për produktet në afat të skaduar.



Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSB-së e mbajtur me 15.05.2024

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit,
 - Siguria në trafik;
 - Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike,
 - Prishja e rendit dhe e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm.
 - Vendosja dhe funksionalizimi i kamareve shtesë të sigurisë në hapësirat publike në rrugët kryesore;
3. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror;

4. Trajtimi i objekteve të braktisura dhe objekteve të vjetra, jo të sigurta;
5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat;
6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;
7. Të ndryshme.

Konkluzion nga takimi i KKSBB-së i datës 14.05.2024

Konkluzioni rreth pikës së dytë: Në Komunën e Rahovecit në bazë të argumenteve dhe burimeve që i posedojmë gjendja vazhdon të mbetet stabile, përkundër faktit që ka sfida, angazhime, përkushtime të secilit institucion, por edhe të komuniteteve, me qëllim që të ruhet edhe më tutje gjendja e sigurisë së përgjithshme. Pra, të ketë qëndrueshmëri dhe stabilitet, sepse për këto kemi nevojë më së shumti. **Konkluzioni rreth pikës së tretë-** Unë besoj që njësia jonë e zjarrfikësve ka pajisje, ka edhe përvjojë. Besoj që edhe komunikimi ndërmjet njësisë sonë dhe qendrës rajonale është i mirë dhe shpresojmë që fushata për edukimin, vetëdijesimin përrrezik nga zjarri dhe mbrojtja nga zjarri, do të vazhdojë dhe do të jenë temë aktuale, jo vetëm nga njësia e zjarrfikësve, po edhe nga të gjithë ne.

Konkluzioni rreth pikës së katërt - Kam kërkuar që Gjeodezia, bashkë me Inspektoratin, Shërbimet Publike, më së paku të tentojmë përpjekje që pronat private të braktisura, që paraqesin rrezik të përgjithshëm përritet, të mbrohet ose të rrënohet, sepse ato mund të shndërrohen edhe në vatrat ku kultivohen, ose ku shfaqen fenomene negative.

Konkluzioni rreth pikës së pestë - Kemi shumë aktivitete dhe fushata kundër ndotjes së ambientit, së paku në ato vende ku mund të dëmtohet kualiteti i ujit, i përenjive. E kemi në fokus dhe prioritet të përbashkët që sa më shumë t'i mbrojmë lumenjtë, brigjet e lumenjve, varrezat, vendet publike. Duhet të kemi maturi, sikurse në oborret tona që nuk kemi mbeturina, njëjtë është edhe në pronën publike.



Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSBB-së e mbajtur me 19.06.2024

Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,

- Siguria në trafik;

- Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe të dasmave;

3. Çështja e ujit të pijshëm në komunën e Rahovecit.

4. Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria për Arsim për maturantët.

5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat,

6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore.

7. Të ndryshme.

Konkluzion nga takimi i KKSBB-së i datës 19.06.2024

Konkluzioni rreth pikës së dytë: Sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës, situata e sigurisë në Komunën e Rahovecit është e qetë dhe stabile, gjithnjë duke u bazuar në informatat e përditshme që më vijnë në zyrë nga stacioni policor në Rahovec.

Konkluzioni rreth pikës së tretë - Në të gjitha projektet që i kemi bashkë me K.R.U. "Gjakova", Komuna e Rahovecit participon me 49%, ndërsa ata me 51%. Janë bërë shumë projekte të përbashkëta, ku kemi dalë të kënaqur, por kohëve të fundit kemi kritika sa i përket menaxhimit të K.R.U. "Gjakova", si me furnizimin e ujit të pijes për Komunën e Rahovecit, ashtu edhe për investimet e përbashkëta kapitale. Vonesat e tyre në punë, kanë bërë që unë mos të jem i kënaqur fare me këtë menaxhment. Shtrimi i gypit të ujit të pijes në njërin nga projektet që i kemi, në rrugën "Gëzim Hamza", ka tre muaj që është duke u zvarritur nga K.R.U. "Gjakova". Ne si komunë jemi në pritje të përfundimit të shtrimit të gypit sipas standardeve, në mënyrë që të bëhet edhe asfaltimi i asaj rruge. Nuk më pëlqen kjo gjendje e krijuar nga KRU - Gjakova, sepse qytetarët e Komunës së Rahoveci janë të irrituar nga mosfinalizimi i punëve me kohë. Kërkoj shpjegim nga menaxhmenti i K.R.U. "Gjakova" rreth kësaj çështjeje, ankesat vijnë edhe gjatë stinës së dimrit nga shumë vendbanime të Rahovecit. Shpresoj që do të jetë hera e fundit që më vijnë ankesa të tillë nga qytetarët, ku fjala kyçë është mungesa e ujit të pijes.



Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSBB-së e mbajtur me 14.08.2024

- . Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit,
 - Siguria në trafik;
 - Masat për parandalimin e lëmoshëkërkuesve;
 - Informatë dhe analizë nga policia e Komunës për çështjen e vjedhjeve dhe të sigurisë së përgjithshme;
3. Informatë për fillimin e procesit mësimor 2024-2025 dhe çështja e sigurisë nëpër shkolla;
4. Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta;
5. Vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtjen e pyjeve dhe të fushave nga zjarri, gjatë sezonit veror, si dhe mbrojtja nga dëmtuesit ilegalë;
6. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat;
7. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;
8. Të ndryshme.

Konkluzion nga takimi i KKSBB-së i datës 14.08.2024

Konkluzioni rreth pikës së dytë: Vlerësimet tona sa i përket gjendjes se sigurisë, përkundër faktit që ka sfida, probleme, pengesa shkelje, kundërvajtje e plot të tjera, nga takimi i fundit i KKSBB-së e deri më tanë, situata në mbarë zonën e përgjegjësisë është e qetë dhe stabile. Kemi pasur shumë plane operative, shumë kërkesa, shumë asistime dhe falë angazhimit të të gjithëve është arritur të menaxhohet situata dhe të ketë rend dhe siguri për të gjithë qytetarët.

Konkluzioni rreth pikës së tretë: Ju njoftoj që janë duke u bërë përgatitjet e nevojshme për një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor. Janë duke ndodhur investime në plot objekte shkollore me eficiencë të energjisë dhe qofshin edhe brenda shkollave, me nyje sanitare. Janë edhe tri çerdhe të tjera të reja që do të fillojnë punën, pas inventarizimit dhe njëkohësisht do të rritet numri i fëmijëve, bashkë me një personel të nevojshëm. Janë duke u vendosur edhe kamera dhe në qytet pothuajse janë funksionalizuar të gjitha, si dhe janë duke u vendosur kamera të reja edhe në shumë pika të tjera, që do ta ndihmojnë mirëmbajtjen e sigurisë jo vetëm në shkolla, por edhe në komunën tonë në përgjithësi.

Konkluzioni rreth pikës së katërt: Ju informojmë që në çdo projekt publik është e paraparë të bëjmë shënjimin i hapësirave që sigurojnë qasje të lehtë të qytetarëve me nevoja të veçanta. Kjo nuk parashihet vetëm në planin e investimeve publike, por edhe te investorët privatë. I rekomandojmë të gjithë ata që ndërtojnë afër rrugëve rrajonale dhe lokale, duhet ta kenë parasysh faktin që është obligative që të kenë hapësira të nevojshme për qasje të qytetarëve me nevoja të

veçanta në objekte, në rrugë, në hapësira, në trotuare etj. Një nga arsyet e vendosjes së ashensorit në objektin e komunës është edhe qasja e qytetarëve që kanë nevoja të veçanta, deri në katin e tretë.

Konkluzioni rreth pikës së pestë: Ka shumë nevojë të kemi vetëdijesim më të lartë për raportim të qytetarëve në numrat kompetentë, sepse kemi shumë dëme edhe në ekonominë pyjore. Si komunë nuk jemi logistikë e dobët, por, 17 zjarrfikës në temperaturatë larta mbi 40, nuk mund t'i mbulojnë të gjitha situatat e paraqitura. Ju ftoj të kontribuoni më shumë dhe të lajmëroni policinë!

Konkluzioni rreth pikës së shtatë: Ne vazhdojmë ta kemi prioritet të lartë edhe mbrojtjen e mjedisit, për një mjeshtëri pa mbeturina. Do të ndërtohet gropat septike në gjashtë pika, të cilat e bëjnë përpunimin dhe filtrimin e ujërave të zeza dhe 70% i nxjerrin si ujëra të bardha.



Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSB-së e mbajtur me 10.10.2024

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit
- Siguria në trafik,
- Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje,
3. Organizimi i fushatave vetëdijesuese përmes aktiviteteve rekreative, kulturore për përmirësimin e komunikimit ndëretnik dhe ndërfetar;
4. Informatë nga Drejtoria për Shërbime Publike lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve dhe të trotuareve për sezonin e dimrit;
5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat;
6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;
7. Të ndryshme.

Shtesë:

Informimi i audiencës dhe i anëtarëve të KKSB-së për misionin, detyrat dhe operacionet e FSK-së.

Konkluzion nga takimi i KKSBB-së i datës 10.10.2024

Konkluzioni rreth pikës së dytë: Situata e sigurisë, në zonën tonë të përgjegjësisë po e ritheksojmë edhe në këtë mbledhje që, është qetë dhe stabile pa ndonjë ndryshim të theksuar. Ka pasur një dinamikë të lartë të aktiviteteve publike. Është zhvilluar një ngjarje e madhe kulturore, Festa e Vjetes së Rrushit – “Hardhfest” dhe me të gjithë ata njerëz, fatbardhësish muk ka pasur incidente. Kjo është dëshmi që ka shumë zhvillime pozitive dhe qytetaria janë është aktive.

Konkluzioni rreth pikës së tretë: Shoqata e Pavarur e Gruas “Hareja” si oja, në bashkëpunim me DKA-në, me DKRS-në, me komandantin e rajonit – perëndim, KFOR-in italian, LMT-në, zv. komandantin e KFOR-it nga Republika e Shqipërisë, që është pjesë e misionit të paqes këtu në komunë, me OSBE-në, me përfaqësues të pakicave, me nxënës dhe me mësues, është zhvilluar një aktivitet shumë i rendësishëm në palestrën sportive “Mizair Isma” me emrin “Paqja e bën jetën”. Kjo ngjarje ka qenë një mesazh që ne angazhohemi për paqe dhe të gjithë ata që kanë qenë në atë ngjarje janë befasuar për të mirë. Besoj që OSBE-ja do të vazhdojë të na ndihmojë për zhvillimin e aktivitetve sportive në vazhdimësi.

Konkluzioni rreth pikës së katërt: Ju njoftoj që Komuna e Rahovecit ka kontratë me dy operatorë ekonomikë që bëjnë mirëmbajtjen e rrugëve gjatë dy sezoneve. Ekoregjioni e ka një pjesë dhe pjesën tjetër e ka Ekodrinia. Këto dy kompani posedojnë pajisje të mjaftueshme që, përveç rrugëve parësore, të kujdesen edhe për rrugë më të ngushta që llogariten si rrugë të pakategorizuara. Ju njoftoj që mbi 200 tonë kripë industriale janë të siguruara për sezonin dimëror. Komuna e Rahovecit, gjithashtu, ka edhe rrugë që menaxhohen nga Ministria e Infrastrukturës. Për shkak të mirëmbajtjes joadekuante nga ministria, kemi vështirësi gjatë dimrit në rrugën Rahovec-Malishevë.

Konkluzioni rreth pikës së shtesë: Mirënjohje për krejt FSK-në dhe për ekipin që ka përgjegjësi të merret me çështjet e sigurisë në bashkësill Bashkëpunimi padyshim do të rritet, thellohet dhe zgjerohet. Ka qenë më se i nevojshëm një prezantim i tillë, i cili më së paku na tregon informata themelore për funksionimin e FSK-së, planin operacional, skemat, sfidat, trajnimet dhe zhvillimin e kapaciteteve. Të pafsha gjeneral ty dhe anëtarësimin e Kosovës në NATO sa më shpejt, faleminderit për prezantimin!

Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSBB-së e mbajtur me 09.12.2024

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit,

- Parandalimi i dhunës në familje,
- Marrja e masave dhe vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike,
- Identifikimi i vendeve ku dyshohet se të rinjtë tanë përdorin substanca narkotike,
- Masat për parandalimin e lëmoshëkërkuesve,
- Reth parkingjeve në qytet dhe ndriçimi publik;

3. Diskutimi rreth sigurisë në komunën e Rahovecit mes anëtarëve të KKSBB-së, kryetarëve të këshillave të lagjeve dhe të fshatrave të komunës së Rahovecit;

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për KKSBB-në për vitin 2025;

5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat.

6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore.

7. Të ndryshme.

Konkluzion nga takimi i KKSBB-së i datës 09.12.2024

Konkluzioni rrëth pikës së dytë: Situata e sigurisë, në zonën tonë të përgjegjësisë nuk ka pësuar ndonjë ndryshim brenda periudhës raportuese nga mbledhja e kaluar, besoj se vazhdon të jetë e qetë dhe stable, pa ndonjë akçes i cili do të duhej të cekej sot.

Komuna e Rahovecit brenda disa dite do të nxjerrë një vendim i cili do të ndalojë përdorimin e mjeteve piroteknike, këtë vendim komuna e Rahovecit është duke nxjerrë për çdo vit.

Konkluzioni rrëth pikës së tretë: Mendoj se bashkëpunimi mes këshillave të lagjeve dhe fshatrave dhe policisë së Komunës së Rahovecit duhet të jetë pak më i madhe. Askush nuk mundet ti dijë të gjitha problematikat e ndonjë lagje apo fshati, policia vepron atëherë kur është e njofuar për ndonjë rast. Prandaj kërkoj që ky bashkëpunim të ritet më shumë, sepse kjo ndikon në sigurinë e komunitetet që ju përfaqësoni.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.10/25
Datë:31.01.2025



Arbëri Zenuni
Kryesues i Kuvendit